



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN, LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E STOMATOLOGËVE

Prishtinë, dhjetor 2019

KUVENDI I ODËS STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Lgjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 21 dhjetor 2019 miraton tekstin e spastruar të Rregullores së përkohëshme për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve. Teksti i spastruar përfshin Rregulloren e përkohëshme për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve e miratuar me 08.07.2019 nga Këshilli Drejtues me autorizim të Kuvendit të dt.14.05.2019; Vendimin e Këshillit Drejtues të dt.29.10.2019 për plotësimin e Rregullores së përkohëshme për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve nr 968 të datës 09.07.2019.

R R E G U L L O R E P Ë R
REGJISTRIMIN, LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E STOMATOLOGËVE

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara nga Kuvendi i OSK-së, me datë
21.12.2019)

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kriteret e regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të doktorëve të stomatologjisë, si dhe specialistëve të lëmive përkatëse të stomatologjisë. Po ashtu me këtë rregullore përcaktohen kushtet e menaxhimit të regjistrave përkatës në të cilët mbahet evidenca e të gjithë stomatologëve që posedojnë licencën, përfshirë stomatologët të cilët rilicencohen.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për procedurat e regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve, si dhe specialistëve të lëmive përkatëse të stomatologjisë.
2. Kjo rregullore përfshinë dispozita edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me procesin e licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve të stomatologjisë.
3. Kjo rregullore nuk zbatohet për licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve me shtetësi të huaj. Licencimi dhe rilicencimi i shtetasve të huaj rregullohet me aktin e veçantë nënligjor të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, në përputhje me Nenin 71, paragrafin 3 të Ligjit për Shëndetësinë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1 **Licencimi** – procedura për dhënien e lejes profesionistit shëndetësor që të merret me veprimtari shëndetësore në Kosovë dhe që është i autorizuar ta ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
- 1.2 **Doktor i stomatologjisë** - nënkupton doktorin e stomatologjisë i cili ka përfunduar programin në arsimim të lartë në ndonjërin nga institucionet e arsimit të lartë të akredituar nga organi kompetent në drejtimin e stomatologjisë;
- 1.3 **Specialisti** – nënkupton stomatologun e specializuar në ndonjërin nga lëmitë e fushës së stomatologjisë;
- 1.4 **Faksimili** – nënkupton vulën unike të cilën i licencuari e përdorë me rastin e lëshimit të dokumenteve dhe raporteve mjekësore në bashkëngjitje të nënshkrimit personal;
- 1.5 **OSK** – nënkupton Odën e Stomatologëve të Kosovës;
- 1.6 **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional; dhe
- 1.7 **MSh** – nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë.

2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

KAPITULLI II – KOMISIONI PËR LICENCIM

Neni 4 Kompetencat dhe përgjegjësitë

1. Komisioni për licencim është komision i përhershëm i OSK-së (në vazhdim Oda) i cili në bazë të autorizimeve ligjore që i janë besuar Odës për të ushtruar kompetencat publike, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1 Mbikëqyrë procesin e regjistrimit dhe anëtarësimit e stomatologëve pranë Odës;

- 1.2 Mirëmbanë dhe menaxhon bazën e të dhënave përkitazi me regjistrin e stomatologëve të licencuar dhe të rilicencuar;
 - 1.3 Vendos në shkallë të parë mbi përmbushjen e kushteve për licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve;
 - 1.4 Udhëheqë me procesin e licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve;
 - 1.5 Me aprovimin përfundimtar të Kryetarit të Odës lëshon licencën e punës.
 - 1.6 Ekzekuton masat disiplinore lidhur me tërheqjen e përkohëshme dhe të përhershme të licencës dhe fshirjen nga Regjistri i anëtarëve të Odës, në bazë të vendimit të formës së prerë të Këshillit Etik apo Gjyqi të Nderit;
 - 1.7 Bashkëpunon me organet të tjera të Odës me qëllim të përmbushjes së funksioneve të përgjithshme të Odës; dhe
 - 1.8 Kryen detyrat të tjera sipas akteve normative të miratuara nga organi kompetent i Odës.
2. Komisionit për licencim mund t'i barten edhe përgjegjësitë të tjera nga organet e Odës përshtatshmërisht me natyrën e funksioneve themelore të parapara me këtë nen.

Neni 5

Përbërja dhe zgjedhja e Komisionit për licencim

1. Komisioni për licencim përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve të cilët zgjedhën nga Kuvendi i Odës nga radhët e anëtarëve të Odës.
2. Anëtarët e Komisionit për licencim kanë mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat në vazhdim.
3. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit për licencim rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës.

KAPITULLI III REGJISTRIMI I STOMATOLOGËVE

Neni 6

Regjistri i anëtarëve

1. Të gjithë stomatologët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale dhe të gjithë stomatologët që kryejnë veprimtari të tjera nga veprimtaria shëndetësore në Republikën e Kosovës, janë të obliguar që të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odë.
2. Komisioni për Licencim është organ kompetent i Odës i cili bën regjistrimin dhe mirëmbanë regjistrat e stomatologëve që anëtarësohen në Odë.
3. Komisioni për Licencim me rastin e regjistrimit të stomatologut në Odë, vlerëson përmbushjen e kushteve të përcaktuar me këtë rregullore për fitimin e statusit të anëtarit të Odës.
4. Vetëm pas verifikimit të plotësimit të kushteve nga ana e Komisionit për Licencim, parashtuesi i formularit për anëtarësim regjistrohet në regjistrin e anëtarëve të Odës, që përndryshe përbën regjistrin e profesionistëve të lëmive të stomatologjisë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 7

Procedura e regjistrimit

1. Procedura e regjistrimit inicohet me dorëzimin e formularit për anëtarësim në Odë (Shtojca I), të cilin e plotëson personalisht stomatologu i cili ka për detyrim ligjor anëtarësimin në Odë.
2. Formulari për anëtarësim do të përmbajë të dhënat personale si në vijim:
 - 2.1 Emri, emri i prindit dhe mbiemri;
 - 2.2 Data dhe vendi i lindjes;
 - 2.3 Numri personal i letërnjoftimit;
 - 2.4 Shtetësia;
 - 2.5 Emri dhe adresa e institucionit ku ushtrohet veprimtaria;
 - 2.6 Statusi profesional/specialistik;
 - 2.7 Numri i licencës
 - 2.8 Statusi akademik;
 - 2.9 Adresa aktuale;
 - 2.10 Të dhënat mbi komunikim, që përfshijnë numrin e telefonit dhe/ose të zyrës apo ai personal dhe adresa e postës elektronike.
 - 2.11 Deklarata nën betim;
 - 2.12 Nënshkrimi, data e aplikimit.
3. Formularit për anëtarësim duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
 - 3.1 Dy (2) fotografi me dimensione 3x4cm;

- 3.2 Kopja e letërnjoftimit të afatshëm;
 - 3.3 Kopja e noterizuar e diplomës së studimeve dhe dëshmi të tjera të cilat vërtetojnë specializimin/aftësimin profesional;
 - 3.4 Kopja e noterizuar e licencës, në rast se e posedon;
 - 3.5 Kopja e noterizuar e vendimit të thirrjes akademike e lëshuar nga organi kompetent (nëse stomatologu ka thirrje akademike); dhe
 - 3.6 të ketë paguar taksën administrative për dorëzim të aplikacionit.
4. Formulari për anëtarësim duhet të nënshkruhet nga aplikuesi dhe të dorëzohet pranë zyrave të Odës. Shërbimi profesional i Odës do të procedojë formularin e tillë për shqyrtim pranë Komisionit për Licencim.
5. Të dhënat personale nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni do përpunohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 8

Anëtarësimi i stomatologëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë Republikës së Kosovës

1. Stomatologët me shtetësi të Republikës së Kosovës të cilët ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe që shprehin vullnetin të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odë, mund të paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim në pajtim me kushtet siç janë paraparë me dispozitat e këtij neni përkitazi me regjistrimin dhe anëtarësimin e mjekëve vendor.
2. Procedura e regjistrimit dhe anëtarësimit do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 6, 7 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Anëtarësimi i shtetasve të huaj

1. Stomatologët që kanë shtetësi të huaj dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Kosovës, janë të obliguar që të anëtarësohen në Odë.
2. Dispozitat lidhur me regjistrimin e stomatologëve me shtetësi të Republikës së Kosovës zbatohen në mënyrë të përshtatshme tek regjistrimi i stomatologëve me shtetësi të huaj, duke përfshirë kushtet shtesë si në vijim:
 - 2.1 Leja e qëndrimit në Republikën e Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi për të huajt;
 - 2.2 Vërtetimi nga Oda e Stomatologëve të vendit të origjinës, me të cilin vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore dhe se ndaj tij nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale;

- 2.3 Barazvlerësimi i diplomës dhe certifikatave të kryera prej tij/saj, të përkthyer dhe të noterizuara;
 - 2.4 Kopja e noterizuar e licencës valide të punës nga vendi i origjinës, nëse është e aplikueshme;
 - 2.5 Njohja e ndonjërës nga gjuhët zyrtare, të vërtetuara nga organi kompetent; dhe
 - 2.6 Në rast se nuk njih ndonjërën nga gjuhët zyrtare, të vërtetojë se ka siguruar përkthyesin e licencuar nga organi kompetent, i cili është i punësuar me orar të plotë në shërbim të mjekut të huaj i cili aplikon për regjistrim dhe anëtarësim.
 - 2.7 Tarifa për regjistrim të anëtarësisë vjetore për stomatologët e huaj që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Kosovës është e përcaktuar me vendim mbi lartësinë e taksave administrative e aprovuar nga Kuvendi i Odës.
3. Regjistrimi i stomatologëve me shtetësi të huaj bëhet sipas procedurës dhe mënyrës së njëjtë, për dallim që evidenca e regjistrimit të tyre menaxhohet në bazë të të dhënave për profesionistët me shtetësi të huaj që mbikëqyret nga Komisioni për Licencim.

Neni 10

Procedura e vendimmarrjes për regjistrim dhe anëtarësim

1. Shërbimi profesional i Odës me rastin e pranimit të formularit për regjistrim, parashtruesit i lëshon një vërtetim me të cilin dëshmohet dorëzimi i formularit për regjistrim dhe anëtarësim në Odë. Në këtë vërtetim shënohet data e dorëzimit, numri i protokollit, dokumentet e dorëzuar dhe numri i faqeve të dokumentacionit, si dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka pranuar formularin dhe dokumentacionin përcjellës.
2. Pas pranimit të dokumentacionit sipas paragrafit 1 të këtij neni, Shërbimi profesional i Odës ia procedon Komisionit për licencim për shqyrtimin e dosjes së dorëzuar.
3. Komisioni për licencim do të shqyrtojë dosjen e tillë dhe për regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit nxjerrë vendim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të formularit.
4. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi regjistrim dhe anëtarësim, Komisioni për licencim mund që:
 - 4.1 Aprovojë regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit;
 - 4.2 Të refuzojë regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj rregulloreje; apo
 - 4.3 Të refuzojë regjistrimin e parashtruesit për shkak të ekzekutimit të masës disiplinore të heqjes nga regjistri.

5. Komisioni për licencim mundet që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për regjistrim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit.
6. Komisioni për licencim do të konsultojë Komisionin Etik lidhur me evidencën e masave disiplinore për vërtetimin e faktit lidhur me zbatimin e masës disiplinore të heqjes nga regjistri të stomatologut ndaj të cilit është shqiptuar masa e tillë disiplinore.
7. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit për licencim sipas paragrafit 4 të këtij neni, mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimi të vendimit.
8. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen përshtatshëmrisht ndaj stomatologëve me shtetësi të huaj.

Neni 11 **Çregjistrimi i vullnetshëm**

1. I anëtarësuar i cili për arsye të shprehjes së vullnetit dëshiron të bëjë çregjistrimin nga anëtarësimi në Odë, duhet ta dorëzojë kërkesën në formë të shkruar në të cilën paraqet arsyet e kërkesës për çregjistrim.
2. Çregjistrimi nga Regjistri i Anëtarësisë mund të bëhet vetëm nën arsye të heqjes dorë nga ushtrimi i veprimtarisë mjekësore.
3. Ndaj vendimit të Komisionit me të cilin refuzohet kërkesa për çregjistrim, pala e pakënaqur mund ta paraqesë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

Neni 12 **Kartela e anëtarësisë**

1. Me rastin e regjistrimit, të anëtarësuarit i lëshohet kartela identifikuese e anëtarësisë në të cilën shënohet:
 - 1.1 Emri dhe Mbiemri;
 - 1.2 Numri i Licencës;
 - 1.3 Data e lëshimit; dhe
 - 1.4 Numri rendor i anëtarësisë.
2. Kartela e anëtarësisë është pronë e Odës dhe si e tillë duhet t'u dorëzohet organeve kompetente të Odës me rastin e skadimit të saj apo në rast të çregjistrimit të stomatologut nga Regjistri i anëtarësisë.

Neni 13

Pagesa e anëtarësisë

1. Anëtarët e Odës kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, sipas vendimit mbi lartësinë e taksave administrative të Odës të nxjerrur nga Kuvendi.
2. Nëse anëtari i Odës nuk i përmbush detyrimet e tij në pajtim me paragrafin paraprak, shërbimi profesional i dërgon atij një paralajmërim.
3. Nëse një anëtar i Odës nuk paguan tarifën e anëtarësisë brenda gjashtë muajve nga marrja e njoftimit, Komisioni merr një vendim që përcakton përfundimin e anëtarësimit në Odë, fshihet nga Regjistri për regjistrimin e anëtarëve të Odës dhe humbet të gjitha të drejtat që rrjedhin nga anëtarësimi i tij në Odë, përfshirë e drejta për licencë.
4. Një anëtar i Odës që humbet statusin e anëtarit, në përputhje me dispozitat e paragrafit paraprak, në rast të paraqitjes së një kërkesë për anëtarësim në Odë, është i detyruar të paguajë dyfishin e tarifës për regjistrim në Regjistër, të përcaktuar me vendim mbi lartësinë e taksave administrative të Odës të nxjerrur nga Kuvendi.

Neni 14

Anëtar nderi i Odës

1. Oda mund të ketë anëtarë nderi në përputhje me këtë rregullore.
2. Anëtarët e nderit janë të liruar nga tarifat e anëtarësimit.
3. Anëtarët e nderit mund të zgjidhen personat për një kontribut të veçantë në punën e Odës.
4. Anëtarët e nderit zgjidhen nga Kuvendi i Odës me propozim të Këshillit Drejtues.

KAPITULLI IV – LICENCIMI/RILICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Neni 15

Detyrimi për licencim/rilicencim

1. Licencimi respektivisht rilicencimi i stomatologëve është i detyrueshëm për të gjithë stomatologët për ushtrimin e veprimtarisë stomatologjike sipas autorizimeve ligjore.
2. Licencimi është procedurë e veçantë administrative që ka karakter zyrtar dhe publik. Komisioni për licencim udhëhiqet mbi bazën e parimeve në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
3. Licenca e punës është dokument publik i cili vërteton përmbushjen e kushteve nga ana e stomatologut, e që janë përcaktuar në mënyrë taksative me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 16

Inicimi i procedurës për licencim/rilicencim

1. Procedura për licencim dhe rilicencim, qoftë licencimin apo rilicencimin e doktorit të stomatologjisë, specialistit të lëmisë përkatëse stomatologjike, inicohen me parashtrimin e aplikacionit që është shtojcë e kësaj rregulloreje (Shtojca II).
2. Parashtruesi i aplikacionit për ri licencim duhet ta parashtrojë kërkesën më së voni 30 (tridhjetë) ditë para datës së skadimit të licencës. Në të kundërtën, ndaj parashtruesit do të shqiptohen gjobat administrative të parapara me këtë rregullore.
3. Shërbimi profesional i Odës me rastin e pranimit të aplikacionit, parashtruesit i lëshon një vërtetim me të cilin dëshmohet dorëzimi i aplikacionit për licencim, respektivisht për rilicencim. Në këtë vërtetim shënohet data e dorëzimit, numri i protokollit, dokumentet e dorëzuar dhe numri i faqeve të dokumentacionit, si dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka pranuar aplikacionin dhe dokumentacionin përcjellës.
4. Pas pranimit të dokumentacionit sipas këtij neni, Shërbimi profesional i Odës i'a procedon Komisionit për licencim për shqyrtimi dosjen e dorëzuar.
5. Aplikacioni për licencim, respektivisht për rilicencim duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet personalisht nga parashtruesi.
6. Aplikacioni përkitazi me rilicencimin e doktorëve të stomatologjisë, specialistëve të lëmiseve përkatëse të stomatologjisë procedohet paraprakisht tek Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional.

7. Komisioni për EVP pasi që të nxjerrë Certifikatën/Vërtetimin për valorizimin e pikëve kredituese, dosjen e tillë së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar me dispozita të kësaj rregulloreje, e procedon pranë Komisionit për licencim.
8. Mënyra e vlerësimit kreditues lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional është nën përgjegjësinë e Komisionit për EVP dhe çështjet përkitazi me këtë procedurë rregullohen me akt të veçantë normativ.

Neni 17

Kushtet për licencim/rilicencim të doktorëve të stomatologjisë

1. Kushtet për licencim të doktorëve të stomatologjisë që duhet përmbushur janë:
 - 1.1 Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2 të jetë i diplomuar në lëminë stomatologjike në ndonjërin nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë apo të ketë të nostrifikuar programin universitar sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3 të ketë dhënë provimin profesional;
 - 1.4 të jetë i regjistruar dhe i anëtarësuar në Odë;
 - 1.5 të ketë paguar kuotën e anëtarësisë në Odë.
2. Për rilicencimin e doktorëve të stomatologjisë, krahas kushteve të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, parashtruesi i aplikacionit duhet të sjell dëshmitë e valorizimit të pikëve të edukimit të vazhdueshëm profesional. Valorizimi i pikëve akredituese bëhet nga Komisioni për EVP, me ç'rast aplikuesit i lëshohet certifikata/vërtetimi me të cilin vërtetohet numri i pikëve akredituese sipas aktiviteteve që janë kryer brenda periudhës përkatëse.
3. Stomatologu i cili ka arritur moshën 65 vjeçare, në momentin e aplikimit duhet të sjell certifikatën mjekësore për punë se është në aftësi për ushtrim të profesionit.
 - 3.1 Kohëzgjatja e licencave nga paragrafi paraprak është 2 vite.
 - 3.2 Taksa administrative për lëshimin e licencës paguhet në përpjesëtim me kohëzgjatjen e licencës, në shumën prej 20 euro për vit.

Neni 18

Përmbajta e aplikacionit dhe dokumentet për dorëzim lidhur me licencimin dhe rilicencimin e doktorëve të stomatologjisë

1. Aplikacioni për licencim dhe rilicencim të doktorëve të stomatologjisë përmbanë të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 Emri i personit, Emri i prindit dhe mbiemri;
 - 1.2 Data dhe vendi i lindjes;
 - 1.3 Adresa e vendbanimit;
 - 1.4 Vendi dhe data e diplomimit;
 - 1.5 Numri personal i letërnjoftimit;
 - 1.6 Të dhënat mbi vendin e punës, respektivisht institucionin shëndetësor, nëse është në marrëdhënie të punës;
 - 1.7 Numri i telefonit;
 - 1.8 Adresa e e-mail;
 - 1.9 Deklarata nën betim;
 - 1.10 Nënshkrimi, data e aplikimit.
2. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e licencimit të doktorit të stomatologjisë janë:
 - 2.1 Formulari për aplikim;
 - 2.2 Kopja e noterizuar e diplomës universitare;
 - 2.3 Në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit, duhet dorëzuar vendimin e noterizuar të organit kompetent për nostrifikimin e diplomave të huaja;
 - 2.4 Certifikata e noterizuar e provimit profesional;
 - 2.5 Kopja e letërnjoftimit;
 - 2.6 Fletëpagesa për licencim;
 - 2.7 Fletëpagesa për anëtarësim ne OSK (ose dëshmi tjetër për pagesën e anëtarësisë për vitin përkatës).
3. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e ri-licencimit të doktorit të stomatologjisë janë:
 - 3.1 Formulari për aplikim;
 - 3.2 Licenca origjinale të cilën e posedon aplikuesi;
 - 3.3 Certifikata/Vërtetimi i valorizimit nga Komisioni për EVP;
 - 3.4 Deklarata nën betim;
 - 3.5 Kopja e letërnjoftimit;
 - 3.6 Fletëpagesa për rilicencim;
 - 3.7 Fletëpagesa për anëtarësim ne Odë (ose dëshmi tjetër për pagesën e anëtarësisë për vitin përkatës).

Neni 19

Përmbajta e aplikacionit dhe dokumentet për dorëzim lidhur me licencimin dhe rilicencimin e specialistëve të stomatologjisë

1. Aplikacioni për licencimin dhe rilicencimin e specialistëve të stomatologjisë përmbanë të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 Emri i personit, Emri i prindit dhe mbiemri;
 - 1.2 Data dhe vendi i lindjes;
 - 1.3 Adresa e vendbanimit;
 - 1.4 Numri personal i letërnjoftimit;
 - 1.5 Vendi dhe data e diplomimit;
 - 1.6 Të dhënat mbi vendin e punës, respektivisht institucionin shëndetësor, nëse është në marrëdhënie të punës;
 - 1.7 Lloji i specializimit;
 - 1.8 Data e specializimit;
 - 1.9 Numri i telefonit;
 - 1.10 Adresa e e-mail;
 - 1.11 Deklarata nën betim;
 - 1.12 Nënshkrimi, data e aplikimit.
2. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e licencimit të specialistëve të stomatologjisë:
 - 2.1 Formulari për aplikim;
 - 2.2 Licenca origjinale e doktorit të stomatologjisë të cilën e posedon aplikuesi;
 - 2.3 Certifikata e noterizuar e provimit specialistik;
 - 2.3.1 Në rast se aplikuesi ka përfunduar specializimin jashtë vendit duhet dorëzuar vendimin e noterizuar të organit kompetent për baras vlerësimin e certifikatës së huaj të specializimit;
 - 2.4 Kopja e letërnjoftimit;
 - 2.5 Fletëpagesa për licencim;
 - 2.6 Fletëpagesa për anëtarësim në OSK (ose dëshmi tjetër për pagesën e anëtarësisë për vitin përkatës).
3. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e ri-licencimit të specialistëve të stomatologjisë:
 - 3.1 Formulari për aplikim;
 - 3.2 Licenca origjinale specialistike;
 - 3.3 Certifikatën/Vërtetimin e valorizimit të pikëve akredituese nga Komisioni për EVP;
 - 3.4 Kopja e letërnjoftimit;
 - 3.5 Fletëpagesa për licencim;
 - 3.6 Fletëpagesa për anëtarësim në Odë.

Neni 20

Vendimmarrja dhe lëshimi i licencës/rilicencës

1. Komisioni për licencim do të shqyrtojë dokumentacionin së bashku me aplikacionin për licencim dhe do të nxjerrë vendim për lëndën përkatëse në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të dokumenteve.
2. Komisioni për licencim do të shqyrtojë dokumentacionin së bashku me aplikacionin për rilicencim dhe do të nxjerrë vendim për lëndën përkatëse në afat prej 30 (tridhjetë) nga dita e dorëzimit të dokumenteve.
3. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi licencim apo rilicencim, Komisioni mund që:
 - 3.1 Të aprovojë kërkesën për licencim apo rilicencim të aplikuesit;
 - 3.2 Të refuzojë licencimin apo rilicencimin e aplikuesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj rregulloreje; apo
 - 3.3 Të refuzojë licencimin apo rilicencimin për shkak të ekzekutimit të masës disiplinore të heqjes nga regjistri ndaj aplikuesit.
4. Komisioni për licencim mund që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për licencim apo rilicencim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit, nëse parashtruesi nuk i përgjigjet afatit për plotësimin e dokumentacionit konsiderohet që nuk ka aplikuar fare.
5. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit për licencim sipas paragrafit 2 të këtij neni, mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimi të vendimit.
6. Në bazë të vendimit të Komisionit për licencim, Kryetari i Odës dhe Kryetari i Komisionit për Licencim e nënshkruajnë licencën e punës e cila i dorëzohet personalisht parashtruesit. Me rastin e dorëzimit të licencës, dorëzimi i tillë do të evidentohet në regjistrin e pranim-dorëzimit të licencave.
7. Aplikuesi i cili me rastin e dorëzimit të dokumentacionit për rilicencim nuk ka dorëzuar licencën origjinale, këtë duhet ta bëjë me rastin e pranimi të licencës së lëshuar. Në të kundërtën të njëjtit nuk mund t'i lejohej tërheqja e licencës.
8. Origjinali i licencës së skaduar i cili dorëzohet nga aplikuesi, do të asgjësohet nga ana e Shërbimit Profesional të Odës.

9. Në rastet të cilat nuk janë të parapara me Rregulloren e Komisionit për Licencim vendos Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 21

Afatshmëria e licencave

1. Licenca për doktorët e stomatologjisë dhe specialistët e lëmive përkatëse të stomatologjisë lëshohet në afat prej 5 (pesë) viteve nga data e nënshkrimit të licencës nga ana e Kryetarit të Odës dhe Kryetarit të Komisionit për Licencim.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, licenca mund të lëshohet në afat më të shkurtër me kërkesë të aplikuesit, nëse arsyeja ka të bëjë me pretendimin e fitimit të titullit specialistik.
3. Licenca e lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni do të lëshohet në përputhje me vitin e fundit të programit specialistik të cilit i nënshtrohet aplikuesi. Aplikuesi duhet të sjell dëshmi (vendimin e lejimit të specializimit nga organi kompetent dhe vërtetimin nga mentori klinik i cili duhet ta dëshmojë vijimin e stazhit specialistik).

Neni 22

Licenca dhe përgjegjësia e përdorimit

1. Licenca e punës lëshohet në vetëm 1 (një) ekzemplar original të cilin mund ta posedojë vetëm stomatologu të cilit i lëshohet licenca, ndërsa një kopje mbetet në dosjen e tij.
2. Licenca në asnjë mënyrë nuk mund të përdoret nga ndonjë person tjetër në mënyrë që të arsyetojë ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore.
3. E drejta e njohur për të ushtruar veprimtari shëndetësore në bazë të licencës së lëshuar nuk mund të bartet e as të autorizohet personi i tretë në shfrytëzimin e saj.
4. Përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e licencës është i licencuari sipas titullit në licencën e lëshuar.
5. Në rast të humbjes së licencës apo të dëmtimit të saj i licencuari duhet ta njoftojë me shkrim Odën posa të jetë njoftuar me një rrethanë të tillë.

Neni 23

Dokumenti i licencës dhe faksimili

1. Dokumenti i licencës së punës i lëshohet të licencuarit së bashku me faksimilin unik të të licencuarit.

2. Dokumenti i licencës përmban të dhënat si në vijim:
 - 2.1 Pjesën hyrëse në të cilën shënohet baza juridike e lëshimit të licencës;
 - 2.2 Emri dhe mbiemri i të licencuarit;
 - 2.3 Thirrja profesionale, përfshirë këtu specializimin;
 - 2.4 Data dhe vendi i lindjes;
 - 2.5 Numri i diplomës apo certifikatës së specializimit;
 - 2.6 Numri i licencës;
 - 2.7 Data e lëshimit dhe data e skadimit të licencës;
 - 2.8 Numri personal i letërnjoftimit dhe
 - 2.9 Nënshkrimi i Kryetarit të Odës-së dhe Kryetarit të Komisionit për Licencim.
3. Me rastin e lëshimit të licencës, të licencuarit i dorëzohet faksimili i cili shërben si shenjë e identifikimit profesional.
4. Faksimili ka këtë përmbajtje:
 - 4.1 Akronimin e OSK-së “OSK”;
 - 4.2 Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
 - 4.3 Thirrjen profesionale për të cilën është licencuar;
 - 4.4 Thirrjen akademike (Prof.Dr; Prof.Asoc.Dr; Prof.Ass.Dr; Ass.Dr. (nëse stomatologu posedon thirrjen); dhe
 - 4.5 Numrin e licencës.
5. Madhësia dhe lloji i shkronjave në faksimil përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Odës.
6. Pronar i faksimilit është OSK-ja dhe me rastin e skadimit të licencës, i licencuari është i obliguar që të dorëzojë faksimilin me rastin e dorëzimit të licencës së skaduar për të cilën është lëshuar faksimili i tillë.

Neni 24

Licenca për specializime të shumëfishta

1. Të licencuarit i cili është i specializuar në më shumë se një lëmi specialistike për secilin specializim i lëshohet licencë dhe faksimil i veçantë për lëminë e specializimit.
2. Licencat për secilin specializim të veçantë kanë numër unik identifikues, dhe si të tillë janë dokumente të veçanta për të cilat poseduesi i tyre ka përgjegjësi për secilën nga to.

Neni 25
Kopja e dublikuar

1. Me kërkesë të anëtarit të Odës, Komisioni mund të lëshojë licencë të dublikuar në rast se origjinali është humbur apo dëmtuar rënd, pas shpalljes së pavlefshme në ndonjërin gazetë. Në kopjen e lëshuar evidentohet se kopja e lëshuar është dublikat i aktit të licencës. Me këtë rast, Komisioni do të lëshojë licencën e dublikuar në afat të përputhshëm me afatin e licencës për të cilën është lëshuar ekzemplari i dublikuar.
2. Parashtruesi i kërkesës për lëshim të ekzemplarit të dublikuar të licencës, është i obliguar që të paguajë taksën administrative për këtë shërbim në përputhje me sistemin e taksave dhe tarifave administrative në fuqi.

Neni 26
Zbatimi i masave disiplinore të shqiptuara nga organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale

1. Komisioni për licencim është organi kompetent për ekzekutimin e masave disiplinore përkitazi me revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të licencës dhe heqjes nga regjistri i anëtarësisë dhe regjistri i licencave.
2. Komisioni për licencim do të bëjë ekzekutimin e masës disiplinore sipas urdhrit të organit kompetent që ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren për Procedurat e Mbikëqyrjes Etike dhe Profesionale të OSK-së.
3. Me rastin e ekzekutimit të masës disiplinore sipas vendimit të organit kompetent, Komisioni për licencim do të njoftojë Këshillin Etik për ekzekutimin e masës së tillë, në mënyrë që të bëhet evidentimi i ekzekutimit të masës disiplinore në regjistrin e veçantë për masat e shqiptuara disiplinore.

Neni 27
Taksat administrative

1. Të gjitha taksat administrative rregullohen me vendim të veçant të miratuar nga Kuvendi i Odës.

Neni 28
Gjobat administrative

1. Në rast se aplikuesi nuk ka përfillur afatin për parashtrimin e aplikacionit për licencim apo rilicencim sipas afateve të parapara me këtë rregullore, ndaj tij do të shqiptohet taksë shtesë

në shumë prej pesë (5) euro për çdo muaj vonesë, nën kërcenimin e ekzekutimit të dhunëshëm në procedurë përmbartimore.

2. Gjobat administrative caktohen me vendim të komisionit për licencim i cili nxjerret në pajtim me këtë rregullore.
3. Vendimi me të cilin caktohet gjoba administrative do të përmbartohet sipas rregullave të procedurës së përgjithshme administrative përkitazi me përmbartimin e akteve administrative.

KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29 Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohen të gjitha dispozitat e mëhershme mbi fushë-veprimtarinë e Regjistrimit, Licencimit dhe Ri-licencimit të Stomatologëve.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Odës.

Prishtinë, 21 dhjetor 2019



Kryetari i OSK-së
Prof. Dr. Blerim Kamberi

SHTOJCA 1

FORMULARI PËR ANËTARËSIM

I. Të dhëna personale (TË DHËNAT DUHET TË SHËNOHEN ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT)

Emri, Emri i prindit dhe mbiemri	
Data dhe vendi i lindjes	
Numri personal i letërnjoftimit	
Shtetësia	
Emri dhe adresa e institucionit shëndetësor, ordinanca/klinika	
Statusi profesional/specialistik	
Numri i licencës	
Statusi akademik	

II. Adresa aktuale

Adresa	
Qyteti	
Kodi postar	

III. Të dhënat e komunikimit

Numri i telefonit mobil	
Email adresa	

IV. Dokumentet e nevojshme

1. Dy (2) fotografi me dimensione 3cm x 4cm,
2. Kopjen e letërnjoftimit të afatshëm
3. Kopja e noterizuar e diplomës së studimeve dhe dëshmi të tjera të cilat vërtetojnë specializimin/aftësimin profesional
4. Kopja e noterizuar e licencës, në rast se e posedon
5. Kopja e noterizuar e vendimit të thirrjes akademike e lëshuar nga organi kompetent (nëse stomatologu ka thirrje akademike)
6. Të ketë paguar taksën administrative për dorëzim të aplikacionit

Deklaratë

Unë, i lartëshënuari me të dhënat personale, e plotësoj këtë formular për anëtarësim për të përmbushur detyrimin ligjor për anëtarësim në Odën e Stomatologëve të Kosovës, në pajtim me dispozitat e Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor. Po ashtu deklaroj nën përgjegjësinë time civile dhe penale se të dhënat e shënuara më lartë janë autentike dhe për deklarimin e tillë kam përgjegjësi ekskluzivisht personale.

Vendi	Data	Nënshkrimi

Plotësohet nga personi i autorizuar i OSK-së

Dokumentacioni është dorëzuar në kopje të noterizuar:			
Licencim të përgjithshëm	Rilicencim i përgjithshëm	Licencimi specialistik/	Rilicencimi specialistik
Formulari për aplikim	Formulari për aplikim	Formulari për aplikim	Formulari për aplikim
Kopja e noterizuar e diplomës universitare	Licenca origjinale të cilën e posedon aplikuesi	Licenca origjinale e doktorit të stomatologjisë të cilën e posedon aplikuesi	Licenca origjinale specialistike
Vendimi i noterizuar i organit kompetent për nostrifikim i diplomave të huaja/ në rast se studimet kryhen jashtë vendit	Certifikata/Vërtetimi i valorizimit nga komisioni për EVP	Certifikata e noterizuar e provimit specialistik	Certifikata/Vërtetimi i valorizimit nga komisioni për EVP
Deklarata nën betim	Deklarata nën betim	Vendimi i noterizuar i organit kompetent për barazvlersimin e ceretifikates së huaj të specializimit	Kopja e letërnjoftimit
Certifikata e noterizuar e provimit profesional	Kopja e letërnjoftimit	Deklarata nën betim	Fletëpagesa për rilicencim
Kopje e letërnjoftimit	Fletëpagesa për rilicencim	Kopja e letërnjoftimit	Deklarata nën betim
Fletpagesa për licencim	Fletpagesa për antarësim ne OSK(deshmi tjetër për pagesen e antarësisë për vitin paraprak	Fletëpagesa për licencim	Fletpagesa për antarësim ne OSK(deshmi tjetër për pagesen e antarësisë për vitin paraprak
Fletpagesa për antarësim ne OSK(deshmi tjetër për pagesen e antarësisë për vitin paraprak		Fletpagesa për antarësim ne OSK(deshmi tjetër për pagesen e antarësisë për vitin paraprak	

Në rast se aplikuesi nuk është anëtar i OSK-së, personi zyrtar vërteton parashtrimin e Formularit për antarësim në OSK dhe përmbushjen e obligimeve statutoire për antarësim.

☐ Parashtruar Formulari për antarësim

☐ Anëtar

Personi i autorizuar i OSK-së

Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Data

V.V.



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Këshilli Drejtues i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK-së) në mbështetje të vendimit nr.937 të dt. 14.5.2019 të Kuvendit të OSK-së për AUTORIZIMIN e Këshillit Drejtues për nxjerrjen e akteve normativ, në mbledhjen e mbajtur me 05.03.2020 miraton këtë:

V E N D I M

- I. Për ndryshimin e nenit 23, paragrafi 4 të rregullorës për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve nr. 1064 të datës 26.12.2019
- II. Pas ndryshimit paragrafi do të ketë këtë përmbajtje
 4. Faksimili ka këtë përmbajtje :
 - 4.1. Llogo zyrtare e OSK-së
 - 4.2. Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit
 - 4.3. Thirrjen profesionale për të cilën është licencuar,
 - 4.4. Thirrjen akademike “Prof.Dr.; Prof.Asoc.Dr; Prof.Ass.Dr; Ass.Dr”
(stomatologët të cilët e posedojnë atë), të vërtetuar me akt juridik përkatës, të noterizuar, apo Grada shkencore “Dr.Sc” (stomatologët të cilët e posedojnë atë), të vërtetuar me akt juridik përkatës, të noterizuar.
 - 4.5. Kodin e licencës.
- III. Pas paragrafit 5, shtohet paragrafi 6 dhe 7 me përmbajtje.
 - a) Paragrafi 6 ka këtë përmbajtje “I licencuari i cili është posedues i dy apo më shumë licencave të punës me specializime të shumëfishta, për secilën licencë specialitike i lëshohet faksimil i veçantë”
 - b) Paragrafi 7 ka këtë përmbajtje “Lëshimi i faksimilave me thirrje akademike apo grade shkencore bëhet vetëm në rastet kur thirrja akademike apo grada shkencore është në

përputhje me kualifikimin profesional specialistik sipas licencës së punës të lëshuar nga Oda.”

IV. Paragrafi 6 i rregullores nr. 1064 i datës 26.12.2020 shëndërrohet në paragrafin 8

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

I' dërgohet:

- Komisionit për Licencim
- Shërbimit Profesional të OSK-së



Kryetari i Këshillit Drejtues

Prof.Dr. Blerim Kamberi